

Në bazë të nenit 20 dhe 32 të Statutit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Parlamenti Studentor i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 12.12.2016 solli këtë:

VENDIM

për përcaktimin e kritereve për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës

Neni 1

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës mund të zgjidhet studenti i rregullt i Universitetit të Tetovës, shtetas i Republikës së Maqedonisë, me notë mesatare 7.00.

Neni 2

Kandidati/kandidatët për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit duhet ta kenë përkrahjen e 1000 (njëmijë) nënshkrimeve të studentëve, prej të cilave detyrimisht nga 7 fakultete të ketë/kenë prej 50-100 nënshkrime.

Neni 3

Kandidatët për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit me dorëzimin e kandidaturave për kryetar, dorëzojnë kandidaturat për 11 kandidatë për Kryetarë në Parlamentet Studentore të fakulteteve dhe 20 kandidatura për anëtarë në Parlamentet Studentore të fakulteteve.

Neni 4

Funksioni i Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës nuk është i njëjtë me funksionin e kryetarit të parlamentit studentor të fakultetit ose anëtarit të parlamentit studentor të fakultetit dhe kryerjen e funksionit në ndonjë parti politike apo ndonjë funksioni tjetër.

Neni 5

Mënyra e dorëzimit të kandidaturave nga nenet paraprahe rregullohen përmes Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij.

Tetovë, më 12.12.2016

Kryetari

i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës

Ardian Bilalli

